

VENDIM
Nr. 322, datë 15.5.2019

PËR KRIJIMIN DHE PËRCAKTIMIN E FORMËS LIGJORE DHE TË STRUKTURËS SË PRONËSISË SË KAPITALIT TË OPERATORIT TË TREGUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 57, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Operatorit të Tregut (Bursa Shqiptare e Energjisë), si struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar ndërmjet platformës së tregut, i cili do të operojë në fushën e shkëmbimit të energjisë elektrike në Shqipëri, në formën e një shoqërie aksionare, të ndarë financiarisht dhe ligjërisht nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., (më poshtë referuar si “OST”).

2. Kapitali fillestar i regjistruar i Operatorit të Tregut nuk do të jetë më pak se 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë, e cila do të financohet nga OST-ja.

3. Në rastin kur persona të tjerë juridikë do të bëhen pjesë në strukturën e pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut, me anën e një procedure konkurrimi, në sipas pikës 1/2, të nenit 57, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, këto subjekte mund të jenë, si më poshtë vijon:

a) operatorë të tjerë të sistemit të transmetimit (më poshtë referuar si “TSO”) të themeluar dhe që operojnë në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë;

b) operatorë me aktivitet ndërkombëtar, me eksperiencë në operimin/menaxhimin e tregjeve të shkëmbimit të energjisë elektrike të themeluar dhe që operojnë në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë, në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri (më poshtë referuar si “Operatorët me Eksperiencë Ndërkombëtare” ose “OEN”);

c) subjekte pjesëmarrëse në tregun e energjisë elektrike, me përvojë në tregtimin e energjisë elektrike në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë (më poshtë referuar si “Pjesëmarrësit e tregut të energjisë” ose “PTE”);

ç) institucione financiare ndërkombëtare (më poshtë referuar si “IFN”).

4. Struktura e aksionarëve që zotërojnë kapitalin, sipas pikës 3, të këtij vendimi, do të jetë:

a) TSO-ja, duke përfshirë këtu edhe OST sh.a., do të kenë të paktën 55,5% të kapitalit;

b) OEN-të mund të kenë jo më shumë se 24,5 % të kapitalit;

c) PTE-të mund të kenë jo më shumë se 10 % të kapitalit;

ç) IFN-të mund të kenë jo më shumë se 10 % të kapitalit.

5. Ngarkohet OST-ja për kryerjen e procedurave ligjore pranë organeve kompetente për regjistrimin e Operatorit të Tregut.

6. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe